



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1645/2 prot.

Elbasan, me 29.06.2023

**VENDIM**

Nr 23, datë 29.06.2023

**"Për nivelin e pagave të personelit mbështetës në Universitetin të Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", si dhe të Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; VKM Nr. 326, date 31.05.2023 , " Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore" lidhja 1; VBA nr 49 datë 13.11.2021 "Për miratimin e numrit te personelit dhe pagat per te gjitha nivelet në Universitetine Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'", Vendimit të Senatit Akademik Nr. 04 , datë 17.03.2023 "Për miratimin e planbuxhetit vjetor 2023", Vendimit të Bordit të Administrimit Nr. 10 , datë 24.04.2023 "Për miratimin e planbuxhetit vjetor 2023" të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", të ndryshuar, Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e nivelit të pagave të personelit mbështetës bazuar në VKM-n Nr. 326, date 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore" lidhja 1) dhe strukturës organizative të pozicioneve ekzistuese të punës në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", janë si më poshtë:

Emërtimi i punonjësit	Niveli i pagës, klasa	Shkalla e vështirësisë së dëmshmërisë
Laborant i mesëm (Teknik)	VII	
Shofer, Punonjës shërbimi (punëtor, lulishtar)	IV	
Punonjës shërbimi (kaldajist)	IV	III
Punonjës pastrimi (sanitar)	I	III

2. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI I BORDIT  
Dr. Ardian Durmishi